REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBETARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KORÇË

Nr. 1719 *Prot.* *Korçë, më* 17 . 11 .2026

SHPALLJE E PROCEDURAVE TË KONKURSIT PËR DREJTUES NË INSTITUCION ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PUBLIK

Në mbështetje të nenit 55 të Ligjit 69/2012 datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 1, nenit 2 dhe nenit 3 të Udhëzimit Nr. 22, datë 13.11.2023, "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar"

Shpallen procedurat e konkurrimit për pozicionin drejtues institucioni arsimor sipas shtojcës bashkëngjitur pjesë përbërëse e kësaj shpallje,

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për pozicionin drejtues instituconi arsimor :

- Të zotërojë arsimimin si mësues sipas përcaktimeve të nenit 57 të ligjit 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar
- Të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar" me vlerësim jo më pak se "mirë" në kualifikimin fundit.
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të jetë certifikuar nga shkolla e drejtorëvë pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm përgatitor për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar .

Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin drejtues institucioni arsimor;

- Jetëshkrimin dhe kopjet e njësuara me origjinalin të dokumentave që dëshmojnë pohimet në të **(sipas modelit të shtojcës 1 të Udhëzimit Nr. 22, datë 13.11.2023, "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar"). (e detyrueshme)**
- Kopje e njësuar me origjinalin e librezës së punës (e noterizuar)
- Kopje e dokumentit të identifikimit (ID).
- Tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr 5 të Udhëzimit).
- Certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor (e noterizuar, e detyrueshme)
- Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore **(sipas shtojcës nr 2 bashkëlidhur udhëzimit)**
- Vërtetim nga institucioni ku punon se aplikanti nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Deklaratën për verifikimin e vërtetësinë të dokumentacionit të paraqitur nga kandidati sipas shtojcës 8 të udhëzimit.
- Deklaratën e mungesës së konfliktit të interesit të aplikantit me punonjësit arsimorë të institucionit arsimor, ku po konkurron për pozicioni drejtues (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prind të bashkëshortit/es) **(sipas shtojcës nr 3 bashkëlidhur udhëzimit).**

Scanned with CamScanner

- Diplomat universitare dhe në rast se është punësuar pas vitit 2011 edhe licencën e ushtrimit të profesionit.(të noterizuara, të detyureshme)
- Kategorinë e fundit të kualifikimit të disponuar (e noterizuar, e detyrueshme)

Dokumentacion shtesë jo i detyrueshëm:

- Certifikata trajnimesh
- Dëshmi e gjuhës së huaj
- Diplomë shtesë në fushën e arsimit (e noterizuar)
- Doktoraturë në fushën e arsimit (e noterizuar)
- Vërtetim për pjesëmarrje në provimet kombëtare (PKAB, MSH) si administrator, përgjegjës administrimi, hartues tekstesh, korrigjues tekstesh.
- Autorësi të teksteve shkollore, tekste për mësuesit ose drejtuesit të shkollës. (ISBN e dukshme tek kopja e noterizuar)
- Shkrime për drejtimin e shkollës/kumtesa në takime ndërkombëtare. (ISBN e dukshme tek kopja e noterizuar)

Aplikanti për drejtues institucioni arsimor duhet të dërgojë dosjen me atë të **shërbimit postar tek ZVAP që mbulon institucionin arsimor ku është shpallur vendi vakant.**

Dosjet duhet të dorëzohen brenda datës 27.11.2026 (brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes), afati është taksativ.

-Komisioni i shqyrtimit të dokumentacionit mblidhet jo më vonë se tri ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit për të bërë shqyrtimin paraprak të dokumentacionit.

-Komisioni shqyrton dokumentacionin për mangësi brenda dy ditë pune dhe njofton me shkrim ose e-mail kandidatin që ka mangësi në dosje.

-Kandidati nga momenti i njoftimit, ka tre ditë pune kohë për të dorëzuar dokumentacionin që mungon.

-Pas përfundimit të këtij afati, komisioni shpall listën me kandidatët që kanë dokumentacionin e plotë dhe të saktë, bën vlerësimin e dosjeve si dhe realizon intervistën e strukturuar brenda një ditë pune.

-Komisioni harton tabelat e pikëve dhe rendit kandidatët sipas shumës së përgjithshme të pikëve, në rendin zbritës dhe brenda tri ditëve pune shpall në këndin e njoftimeve të IPAP-së tabelat e pikëve totale të secilit kandidat, sipas shtojcës nr. 7, bashkëlidhur Udhëzimit.

-Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankim me shkrim para Komisionit brenda tri ditëve pune nga shpallja e rezultateve të konkurrimit. Komisioni shqyrton ankesat brenda një dite pune.

-Në rast se nuk konstatohen probleme proceduriale, ZVAP përcjell në DRAP emrat e dy kandidatëve me më shumë pikë brenda dy ditëve.

-Drejtori i DRAP realizon intervistat brenda 5 ditëve pune nga momenti i marrjes dijeni të dy kandidatëve me më shumë pikë.

-Brenda tri ditë pune, drejtori i DRAP shpall fituesin e vendit për drejtor IAP publik.

-Kandidati jofitues ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda tri ditë pune në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Kandidati ankimues merr përgjigje nga Ministria e Arsimit dhe Sportit brenda 10 ditëve pas mbarimit të afatit të ankimimit.

DREJTOR

VINJOLA ROTA

Scanned with CamScanner

SHTOJCË

1.

ZVAP	SHKOLLA KU HAPET KONKURSI PER DREJTOR
ELBASAN	"KOSTANDIN KRISTOFORIDHI"
ELBASAN	"DHASKAL TODRI"
ELBASAN	"QAMIL GURANJAKU"
ELBASAN	"KOSTANDIN SHPATARAKU" GJINAR
ELBASAN	KUQAN
ELBASAN	"JORGJI DILO"
ELBASAN	"ALI SOLLAKU" THANE

Adresa ku do të dorëzohen dosjet: ZVAP Elbasan, Lagjia: Dyli Haxhire, Rruga Janaq Kilica, Nr 21, Elbasan.

2.

ZVAP	SHKOLLA KU HAPET KONKURSI PER DREJTOR
POGRADEC	"GJOK SHQIPTARI"
POGRADEC	"M.E. MINAROLLI"
POGRADEC	"SHEME MAHMUTLLARI" RRËMENJ
POGRADEC	"SERVET AGOLLI" BUÇIMAS
POGRADEC	VELÇAN
POGRADEC	"PTOLEME XHUVANI" MEMELISHT
POGRADEC	DUNICË
POGRADEC	"QEMAL BAZELLI" ÇËRRAVË

Adresa ku do të dorëzohen dosjet: ZVAP Pogradec, Godina e Bashkisë, Bulevardi "Europa", 7301, Pogradec.

3.

ZVAP	SHKOLLA KU HAPET KONKURSI PER DREJTOR
KORÇË-PUSTEC	"MËSONJËTORJA E PARË SHQIPE"
KORÇË-PUSTEC	"PANDELI CALE"
KORÇË-PUSTEC	"YMER DISHNICA"
KORÇË-PUSTEC	"DEMOKRACIA"
KORÇË-PUSTEC	"ASDRENI"

Adresa ku do të dorëzohen dosjet: ZVAP Korçë-Pustec, Lagjia 18, Rr: Dhimitër Denasi, Korçë.

Scanned with CamScanner